# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-433216**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Reforma territoriale, ambasadori i OSBE-së: Nuk duhet të merret asnjë vendim pa u konsultuar në nivelin kombëtar |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/reforma-territoriale-ambasadori-i-osbe-se-nuk-duhet-te-merret-asnje-ven-i584965` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 13:01:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 9 shtator 2026, 14:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `028d4e276539bca4b2930c4e05caecbf62e49db70f3fff9d3da0d081fe56a446` |
| TEKSTI | `14e0006f18572666ac6a093f16768b8f49547a6cc6a5cbe1a3eb1c3c0f2841bf` |
| PAMJA | `8b8a1cc3ab962c2146e1a5fd3f5c770180d77ac3d293a0e3ebac19a29e83cc27` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e33433b9e21461032693d8069b2fed2c147732c0bc4f1efae58f334fc77e6313` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e33433b9e21461032693d8069b2fed2c147732c0bc4f1efae58f334fc77e6313`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Reforma territoriale, ambasadori i OSBE-së: Nuk duhet të merret asnjë vendim pa u konsultuar në nivelin kombëtar

9 Shtator 2026, 16:30Politika TEMA

Reforma territoriale, ambasadori i OSBE-së: Nuk duhet të merret

Ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, Michel Tarran, ka deklaruar nga Pogradeci se për reformën territoriale ende nuk është marrë asnjë vendim përfundimtar, ndërsa procesi ndodhet në fazën e diskutimeve dhe konsultimeve. I pyetur nëse, bazuar në monitorimin e kryer nga OSBE-ja, procedurat e konsultimit për reformën territoriale janë zhvilluar në mënyrën e duhur, Tarran tha se është ende herët për të dhënë një vlerësim përfundimtar.

*"Mesa di unë, ende nuk është vendosur asgjë. Jemi akoma në fazën e diskutimit, jemi akoma në fazën e konsultimit. Nuk duhet të merret asnjë vendim pa u konsultuar në nivelin kombëtar, por edhe në nivelin lokal"*, deklaroi ambasadori. Ai theksoi se konsultimi është ende një proces në zhvillim dhe se vetëm në një fazë të mëvonshme mund të vlerësohet nëse ka qenë i mjaftueshëm apo nëse janë evidentuar problematika. *"Me sa di unë, ky konsultim është një proces që tani bëhet dhe është akoma herët për të thënë nëse ky konsultim u bë në mënyrë të mjaftueshme ose nëse ka pasur problem nga kjo pikëpamje"*, u shpreh Tarran.

Ambasadori i OSBE-së sqaroi gjithashtu se organizimi territorial i Shqipërisë është një çështje që i takon vetë vendit dhe se OSBE-ja nuk imponon një model të caktuar.

*"Së pari, unë nuk përfaqësoj këtu BE-në, unë jam përfaqësues i OSBE-së dhe në OSBE kemi 57 vende pjesëmarrëse me sisteme shumë të ndryshme"*, tha ai.

Duke sjellë si shembull Francën, vendin e tij të origjinës, Tarran theksoi se modelet e organizimit territorial ndryshojnë ndjeshëm nga një shtet në tjetrin. *"Unë vij nga një vend që për këtë çështje ka një situatë shumë të veçantë. Deri tani kemi 35 mijë komuna/bashki në Francë. Ka vend tjetër ku ka disa dhjetëra bashki. Nuk ka një model që ne imponojmë apo e konsiderojmë si më të mirë"*, deklaroi ambasadori.

Sipas tij, çdo vend duhet të përcaktojë vetë mënyrën e organizimit të administratës territoriale, duke marrë në konsideratë historinë, traditat dhe nevojat e tij. *"Çdo vend ka historinë e vet, çdo vend ka traditat e veta, çdo vend ka nevojat e veta. Dhe sigurisht është puna e vendit, e Shqipërisë, që të vendosë si duhet të organizohet administrata territoriale, me 61 bashki siç është rasti tani, ose me 100, 40 apo 3000. Nuk është puna ime që t'ju tregoj si duhet të organizohet administrata lokale"*, u shpreh Tarran.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Reforma territoriale, Ambasadori i OSBE: Nuk ka një model unik, Shqipëria duhet të vendosë vetë për bashkitë

Reforma territoriale, Ambasadori i OSBE: Nuk ka një model unik, Shqipëria duhet të vendosë vetë për bashkitë

13:45 Politika

“A nuk ju vjen turp?” - Rama u përgjigjet Demokratëve Europianë: Dhuna ndaj deputetëve nuk është “kundërshtim demokratik”

11:53 Politika / 40 komente

Ambasadorja e re e Bashkimit Europian, takim me kryetarin e Kuvendit

10:56 Politika

Rama mbledh drejtuesit politik në "Vilën e Kuqe", në fokus “Besa” dhe “Prania Besnike”

10:45 Politika / 18 komente

“Opozita është pa ide të reja”, Çupi: Sjellja e ‘revolucionit të flamingove’, e dhunshme dhe rrugaçërore

07:24 Politika / 7 komente

‘Territorialja’/ Mazniku: Shumë bashki nuk kryejnë dot funksionet! Reforma është për qytetarët, në zgjedhje synojmë hartën e re

22:10 Politika / 3 komente

Protestuesit ndoqën deputeten Iris Luarasi me thirrje fyese, reagon Rama: Çfarë mjerimi mendor!

21:50 Politika / 85 komente

VIDEO/ "S'kam qenë ndonjëherë, por..." - Habit protestuesi: Shqipëria për tre muaj bëhet më mirë se Zvicra

21:46 Politika / 19 komente

“Hiqe këtë pankartë!”, Këshilltari socialist përplaset ashpër me aktivistin në studio: Kjo s’është protestë, janë huliganë!

21:20 Politika / 16 komente

VIDEO/ “Patronazhist, të q**sha robt” – protestuesit përplasen me njëri-tjetrin për bllokimin e rrugës

21:10 Politika / 37 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...**

14:15 Politika / 53 komente

**FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...**

17:35 Politika / 110 komente

**Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...**

14:50 Politika / 10 komente

**Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...**

22:50 Kronika / 4 komente

**Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...**

19:40 Politika / 118 komente

## Blog Tema

**Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet…**

13:00 Blog / 1 koment

**Një debat që nuk duhet të mbarojë te telefonat**

09:45 Blog / 3 komente

**25-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit: Maqedoni, mars-gusht 2001**

09:15 Blog / 5 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit | REGJISTROHU

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.